



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2026

**PROCES VERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOS NDARJEN E PROCEDURËS
SË PROKURIMIT NË LOTE**

Objekti : Blerje Makina Elektrike

Fondi limit : 19,700,000 (Nentembdhjete million e shtateqind mije) Leke pa TVSH

Fondi Limit : 212,147 (dyqind e shtatedhjete e nentemije e nenteqind e gjashtedhjete e shtate)
Euro, me kurs kembimi 92.86 sipas Bankes se Shqiperise date 17.08.2026

Kodi CPV: 34144900-7 - Automjete elektrike

Tipi i Proçedurës: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF-96731-08-19-2026

Duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor sqarojme se:

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Në bazë të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar AK nuk është i detyruar ta ndajë në lote por duhet të justifikojë vendimin e vet. Kjo procedurë ndahet në lote për këto arsye:

Objekti : Blerje Makina Elektrike

Fondi limit : 19,700,000 (Nentembdhjete million e shtateqind mije) Leke pa TVSH

Fondi Limit : 212,147 (dyqind e shtatedhjete e nentemije e nenteqind e gjashtedhjete e shtate) Euro, me kurs kembimi 92.86 sipas Bankes se Shqiperise date 17.08.2026

Kodi CPV: 34144900-7 - Automjete elektrike

Tipi i Proedurës: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF-96731-08-19-2026

Pas analizimit të natyrës, objektit dhe karakteristikave teknike të furnizimit, Autoriteti Kontraktor vlerëson se mosndarja e procedurës në lote është e arsyeshme dhe proporcionale, për këto arsye:

1. Objekti i prokurimit është homogjen.

Procedura ka për objekt furnizimin me 10 automjete elektrike, do të përdoren për të njëjtin qëllim institucional. Për rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me produkte apo kategori të ndryshme që kërkojnë trajtim të veçantë në lote.

2. Standardizimi i flotës sjell përfitime në mirëmbajtje dhe administrim.

Furnizimi i të gjitha automjeteve nëpërmjet një kontrate të vetme mundëson standardizimin e flotës së automjeteve elektrike, duke lehtësuar administrimin, mirëmbajtjen periodike, diagnostikimin teknik, furnizimin me pjesë këmbimi dhe menaxhimin e garancisë. Ndarja në lote dhe përzgjedhja potenciale e operatorëve të ndryshëm mund të sjellë marka, modele ose konfigurime të ndryshme, duke rritur kompleksitetin e administrimit dhe kostot e mirëmbajtjes gjatë periudhës së përdorimit.

3. Unifikimi i përgjegjësisë kontraktore.

Duke qenë se automjetet janë të destinuara për përdorim institucional dhe kërkohet garanci minimale 5 vjet, është në interes të Autoritetit Kontraktor që përgjegjësia për furnizimin, dorëzimin, dokumentacionin, garancinë dhe shërbimet pas shitjes të jetë e përqendruar te një operator ekonomik. Kjo shmang fragmentimin e përgjegjësive dhe lehtëson trajtimin e çdo problematike që mund të lindë gjatë zbatimit të kontratës.

4. Efikasiteti ekonomik dhe administrativ.

Një kontratë e vetme për të gjithë sasinë mundëson realizimin e procedurës dhe administrimin e saj në mënyrë më efikase, duke shmangur përsëritjen e proceseve administrative, të verifikimeve teknike, të dokumentacionit të dorëzimit dhe të procedurave të pranimi për kontrata të ndryshme.

Mosndarja e kontratës në lote nuk synon dhe nuk sjell përjashtimin e operatorëve ekonomikë të aftë për të furnizuar objektin e prokurimit. Kriteret e përzgjedhjes dhe specifikimet teknike do të hartohen në mënyrë proporcionale, objektive dhe jodiskriminuese, duke i dhënë mundësi pjesëmarrjes të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë kapacitetin profesional, teknik dhe ekonomik për të realizuar furnizimin.

Ky përcaktim bëhet duke respektuar parimet e konkurrencës, transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, si dhe duke garantuar që kërkesat teknike dhe kriteret e kualifikimit të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës.